



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: AGROEKONOMI

Programi: EKONOMIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidatja GANI KEROLLI, me titull: **“Vlerësimi i Riskut të kredive bujqësore nga institucionet financiare në Kosovë”** ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 23.05.2024 deri me datë 29.05.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Dr. Arben MUSLIU kryetar,
2. Prof. Asoc. Dr. Jehona SHKODRA, mentor - anëtar,
3. Prof. Dr. Sejdi REXHEPI, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte të udhëheqësi shkencor i temës Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra, përmes e-mail adresës jehona.shkodra@uni-pr.edu

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë!

ABSTRAKT

Ky studim hulumton menaxhimin e rrezikut të kredive bujqësore nga institucionet financiare (IF) në Kosovë. Qëllimi i hulumtimit është që të bëjmë një analizë të riskut të kredive bujqësore, dhe të shohim efektin e menaxhimit të riskut të kredive bujqësore nga institucionet financiare si dhe mënyrën e menaxhimit të kredive nga institucionet financiare.

Hulumtimi është realizuar nga intervistimi i 50 punonjës në banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione të tjera financiare nga një pyetësor i formuluar prej 17 pyetjeve. Të dhënat janë analizuar në programin statistikor SPSS 21.0. Në bazë të metodave të përdorura hulumtimi do të orientohet me theks të veçantë drejt rreziqeve të cilat do të ndikojnë në reputacionin e institucioneve financiare. Bazuar në hulumtimin e bërë kemi arritur në një fazë për të kuptuar kuadrin teorik duke përfshirë hipotezat e përgjithshme si dhe të dhënat e mbledhura nga hulumtimi i realizuar. Krahasimi i variablave është bërë në bazë të gjinisë duke përdorur T-testin për mostra të pavarura, si dhe në bazë të institucioneve financiare “Bankave”, “Mikrofinancave” dhe “institucioneve tjera” duke përdorur Anova për krahasimin e tri variablave të pavarura me testin LSD.

Gjetjet tregojnë se IF përballen me rreziqe për menaxhimin e kredive bujqësore. Mjetet për menaxhimin e rreziqeve përfshijnë kolateralin, teknikat e vlerësimit, diversifikimin e aktiviteteve bujqësore, detyrimet, garancitë.

Prandaj, për të menaxhuar rreziqet e kredive bujqësore, IF duhet t'i përdorin këto mjete në mënyrë optimale. Për më tepër, ekspozimi i fermerëve ndaj praktikave të tregut të lirë do t'u mundësojë atyre të mbulojnë kostot e tyre operacionet, dhe për të shlyer kreditë.

Fjalët kyçe: Vlersimi i rrezikut, kredi bujqësore, menaxhim, IF, Kosovë.

ABSTRACT

This study analyses the risk management of agricultural loans by financial institutions (FI) in Kosovo. The aim of the study is to analyse the risk of agricultural loans and to examine the impact of risk management of agricultural loans by FI and the way of credit management by FI.

For the study, 50 employees of banks, microfinance institutions and other financial institutions were interviewed using a questionnaire with 17 questions. The data was analysed using the statistical programme SPSS 21.0. Based on the methods used, the research will focus on the risks that affect the reputation of financial institutions. Based on the research conducted, we have reached a stage where we understand the theoretical framework including the general hypotheses as well as the data obtained from the research conducted. The comparison of variables was done on the basis of gender using the T-test for independent samples and on the basis of financial institutions "banks", "microfinance" and "other institutions" using the Anova for the comparison of three independent variables with the LSD test.

The results show that FI are exposed to risks in the management of agricultural loans. Risk management tools include collateral, valuation techniques, diversification of agricultural activities, commitments and guarantees.

To manage agricultural credit risks, FI should therefore optimise the use of these tools. Exposing farmers to free market practises will also allow them to cover their operating costs and repay the loans.

Keywords: risk assessment, agricultural credit, management, FI, Kosovo.